



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0095268/22-20 dt. 26.10.2022

Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenin 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 dhe nenin 46 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të Komunës; nenin 19 dhe nenin 20, paragrafi 3, të Rregullores Nr. 11/2013 për subvencione dhe transfere, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 26.10.2022, pasi shqyrtoi Propozimin për subvencionimin e personave të prekur nga kanceri; sjell këtë:

VENDIM

Për subvencionimin e personave të prekur nga kanceri

1. MIRATOHET Vendimi për subvencionimin të personave të prekur nga kanceri në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
2. Sipas pikës 1, të këtij vendimi 5,000.00 (pesëmijë) € ndahen për personat e prekur nga kanceri, banorë të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
3. Mjetet e lejuara sipas pikës 2, të këtij vendimi ipen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere dhe paguhen në xhirollogaritë personale të aplikuesve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAP

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Drejtorisë për Shëndetësi

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa